# Kosova e pavarur këtë vit

**Prizren, 16 prill** - Shefi i UNMIK-ut, Joachim Ruecker, dhe komandanti i KFOR-it, Roland Kather, thanë të hënën në Prizren se Kosova këtë vit do të bëhet e pavarur, falë vullnetit të popullit të saj, por edhe angazhimit të faktorit ndërkombëtar. Këto komente ata i bënë në ceremoninë e organizuar me rastin e përvjetorit të Gjimnazit "Loyola", ku mësimet i ndjekin nxënës të përkatësive të ndryshme etnike. Gjenerali Kather u zotua se KFOR-i do të përkujdeset për sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë, sidomos në këtë periudhë tranzicioni.



Joachim Ruecker dje në Prizren